REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
NJESIA E AUDITIT TE BRENDSHEM

Nr. _____prot. Prrenjas më ___.___.2026

KARTA E AUDITIT TE BRENDSHEM

I. STATUSI ORGANIZATIV I NJESISE SE AUDITIT TE BRENDSHEM.

Struktura e njesise se Auditit te Brendshem ne Bashkine Prrenjas eshte miratuar me vendim te keshilli Bashkiak dhe eshte ne varesi te drejteperdrejte nga titullari i bashkise Prrenjas ne perputhje me nenin 10 te ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 "Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik" i ndryshuar
Autoriteti i vetem tek i cili pergjigjet dhe raporton Njesia e AB eshte titullari i njesise publike dhe nga ana metodologjike varet nga Njesia Qendrore e Harmonizimit te Auditimit te Brendshem,ne Ministrine e Financave.
Stafi i Njesise se auditit te brendshem,punesohet sipas dispozitave te legjislacionit ne fuqi per nepunesin civil,mbeshtetur ne kerkesat e pergjitheshme te percaktuara ne ligjin per AB.

II. MISIONI,QELLIMI DHE OBJEKTI I PUNES.

Karta e Auditit te Brendshem eshte nje akt administrativ qe miratohet nga titullari i Bashkise ,ne zbatim te ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 "Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik" neni 4 pika 12.
Karta e Auditit te Brendshem eshte hartuar ne perputhje me Ligjin nr 114/2015 date 22.10.2015 "Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik" ,Kodin e etikes te miratuar me Urdher te Ministrit te Financave nr 86 date 10.12.2015,Manualin e Auditit te Brendshem miratuar dhe Standarteve Nderkombetare te Auditimit.

- **Misioni**

Misioni i Njesise se Auditit te Brendshem eshte te jape siguri te arsyeshme per

Titullarin ne menyre te pavarur dhe objektive,si dhe keshilla per permiresimin e veprimtarise dhe efektivitetin e sistemit te kontrollit te brendshem ne Njesine Publike dhe institucionet ne varesi .
Auditi i Brendshem ndihmon titullarin e njesise publike te arrije objektivat e veta nepermjet rekomandimeve per permiresimin e veprimtarise dhe efektivitetin e kontrollit te brendshem ne menaxhimin e riskut si dhe proceset e qeverisjes.

- **Qellimi**

Auditi i Brendshem ka si qellim te mbeshtese Titullarin e Njesise Publike per te arrituar objektivat e percaktuara duke identifikuar dhe vleresuar risqet, duke vleresuar sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe duke dhene rekomandimet per permiresimin e veprimtarise se Njesise Publike dhe institucioneve ne varesi.

- **Objekti i Punes dhe Veprimtaria e Auditit te Brendshem**

Objekti i punes se Njesise se AB eshte ti japе mbeshtetje titullarit ,drejtuesve te drejtorive brenda njesise ,drejtuesve te institucioneve te varesise,ne arritjen e objektivave nepermjet:

1. Pergatitjes se planeve strategjike dhe vjetore bazuar ne vleresimin objektiv te riskut duke u fokusuar ne perzgjedhjen e llojit te auditimit dhe identifikimin e fushave te cilat ndikojne ne arritjen e objektivave ,te percaktuara ne planin e Njesise Publike.
2. Kryerjen e auditimeve ne baze te planit te miratuar duke ruajtur frekuencen e auditimit ,vleresimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
3. Vleresimin e sistemit te kontrollit te brendshem lidhur me pershtatshmerine dhe efektivitetin e kontrollit te brendshem,si ne sistemet financiare dhe ne ato jofinanciare.
4. Dhenies se rekomandimeve per permiresimin e veprimtarise dhe efektivitetin e sistemit te kontrollit te brendshem.
5. Monitorimit te zbatimit te rekomandimeve te dhena.

III. PAVARESIA DHE RREGULLIMET LIGJORE QE SIGUROJNE PAVARESINE.

Funksioni i Audituesit te Brendshem ka status te pavarur brenda institucionit te Bashkise ne dhenien e rekomandimeve .Pavaresia percaktohet si te qenurit i lire nga kushtet qe kercenojne te qenurit objektiv.Objektiviteti apo gjykimi i paanshem i mundeson audituesve qe te kryejne angazhimet ne menyre qe te kene besim per sa i perket produktit te punes se tyre dhe te mos bejne kompromis per sa i perket cilesise. Punonjesit e Auditit te Brendshem kane pavaresi funksionale dhe organizative.

- **Pavaresia funksionale** nenkupton se strukturat e auditimit jane te pavarura ne planifikimin ,kryerjen dhe raportimin e rezultateve te auditimit nga subjekti qe auditohet.Kryerja e auditimit zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe standarteve te propozuara dhe nuk i nenshtrohen asnje ndikimi tjeter nga individe me autoritet qofshin brenda ose jashte njesise.

- **Pavaresia organizative** brenda Njesise nenkupton qe drejtuesi i Njesise se Auditit te Brendshem raporton direkt tek titullari i Bashkise dhe Njesia e Qendrore e Harmonizimit te Auditimit te Brendshem.
  Struktura e Auditimit nuk mund te angazhohet ne detyra te tjera brenda organizates te cilat nuk lidhen me funksionin e auditimit te brendshem.Ato jane pjese e struktures se menaxhimit dhe jo e strukturave operacionale te Bashkise.
  Audituesit duhet te mbajne qendrim te paanshem dhe ti shmangen konfliktit te interesit .Duhet te tregojne se jane te pavarur dhe objektiv duke respektuar deklaraten e pavaresise .

IV. ROLI DHE PERGJEGJESITE E SEKTORIT TE AUDITIMIT TE BRENDSHEM TE PERGJEGJESIT DHE AUDITUESVE TE SAJ DHE MENYREN SE SI REALIZOHEN ATO.

Sistemet kryesore te identifikuara nga njesia e Auditit te Brendshem jane financiare dhe jofinanciare.Ne sistemet financiare jane perfshire programe vjetore dhe strategjike fushat te cilat jane te njohura sesi funksionojne , si buxheti,kontabiliteti ,pagesat ,te ardhurat,prokurimet,investimet ndersa ne sistemet jofinanciare jane perfshire fusha te cilat lidhen direkt me ofrimin social.
Per te arritur qellimet dhe objektivat e percaktuara te Njesise Publike ,do te vleresohet pershtatshmeria dhe efektiviteti i qeverisjes,rrezikut te menaxhimit te njesise dhe kontrolleve te brendshme si dhe cilesia e performances per kryerjen e pergjegjesive te caktuara.
Kjo perfshin:

a) Vleresimin e ekspozimit ndaj riskut ne lidhje me arritjen e objektivave strategjike te Bashkise,kjo e shprehur ne Deklaraten vjetore dhe strategjike.
b) Vleresimin e besueshmerise dhe integritetin e informacionit dhe mjetet e perdorura per te identifikuar,matur,klasifikuar dhe per te raportuar nje informacion te tille.
c) Vleresimin e sistemeve te vendosura per te siguruar perputhjen me politikat planet procedurat ,ligjet dhe rregulloret te cilat mund te kene ndikim te rendesishem ne Njesine Publike.
d) Vleresimin e mjeteve dhe ruajtjen e pasurise,verifikimin e ekzistences se aktiveve.
e) Vleresimin e efektivitetit dhe efikasitetin me te cilen burimet jane perdorur.
f) Vleresimin e veprimeve financiare (transaksioneve) apo programeve per te vertetuar nese rezultatet jane ne perputhje me objektivat e vendosura dhe nese veprimet financiare ose programet jane duke u kryer sipas parashikimeve.
g) Monitorimin dhe vleresimin e proceseve te qeverisjes.
h) Monitorimin dhe vleresimin e efektivitetit te proceseve te menaxhimit te riskut te Njesise Publike dhe institucioneve te varesise.
i) Vleresimin e cilesise se performances se audituesve te brendshem pjese e grupit te auditimit te marre nga jashte sektorit te AB.
j) Raportimin periodik per veprimtarine e AB lidhur me qellimin,autoritetin,pergjegjesine dhe performances,ne lidhje me planin e miratuar.
k) Vleresimin e pershtatshmerise se veprimeve financiare (transaksioneve) te vecanta me kerkese te menaxhimit.

Organizimi

Pergjegjesi i njesise se AB do te raportoje tek titullari i njesise publike i cili ne zbatim te ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 i ndryshuar do te miratoje:

a) Karten e Auditit te Brendshem
b) Planet e auditimit te brendshem vjetor dhe strategjik.
c) Buxhetin dhe burimet e auditimit.
d) Performancen e veprimtarise se njesise se auditit te brendshem dhe ceshtje te tjera.
e) Kryerjen e veprimeve me natyre investiguese mbi veprimtarine e rendesishme brenda Bashkise dhe institucioneve te varesise te dyshuara per mashtrim dhe per kete drejtuesi i njesise te njoftoje titullarin e bashkise.
f) Perfundimet e angazhimit te auditimit dhe rekomandimet e lena per te cilat eshte rene dakort me menaxhimin e subjektit te audituar nepermjet memorandumit nga ana e grupit te auditimit dhe konfirmimit nga ana e drejtuesit te njesise.

Audituesi i brendshem do te raportoje te drejtuesi i njesise se auditimit i cili do te miratoje:

a) Deklaraten e pavaresise se audituesit.
b) Programin e angazhimit te auditimit.
c) Rezultatet e angazhimit te auditimit dhe rekomandimet nepermjet hartimit sipas struktures se miratuar ne Manualin per Auditimin e Brendshem te Projekt Raportit dhe Raportit Final brenda afateve te percaktuara.
d) Venien ne dispozicion te drejtuesit te njesise te dosjes se auditimit para kryerjes se procedurave te arshivimit per te mundesuar vleresimin e brendshem te cilesise.

V. AUTORITETI I AUDITIMIT TE BRENDSHEM

Autoriteti

Pergjegjesi i Njesise se Auditimit te Brendshem dhe audituesit jane te autorizuar :

- Te kryejne auditime ne pajtim me programin e aprovuar.
- Te kene aksese te pakufizuar tek te gjitha regjistrat ,dokumentat,llogarite ,korespondencen,asetet fizike dhe te dhena te tjera te subjektit qe ai i cmon te nevojshme ne kryerjen e procesit te auditimit.
- Te ushtroje ne menyre te pavarur funksionin e auditimit pa lene hapesire per nderhyrje nga koleget ,mbikqyresit ,drejtuesit e njesise se auditimit apo pala e audituar me perjashtim te mardhenieve te ndersjellta te keshillimit.
- Te kerkoje te gjitha te dhenat me karakter teknik,ekonomik dhe financiar dhe te drejtimit per subjektin qe auditohet duke marre persiper ruajtjen e fshehtesise se tyre sipas legjislacionit ne fuqi.
- Te marrin nga punonjesit e subjektit te audituar ,per rastet qe gjykohet e nevojshme shpjegime ,deklarata dhe fotokopje te dokumentuara ne te cilat drejtuesi i subjektit te audituar ka vene shenimin “e njejte me origjinalin” si dhe

materiale te transportueshme ,ne forme elektronike ,qe kane lidhje me auditimin e brendshem te subjektit.

- Te kene kushtet e nevojshme ,zyre dhe pajisjet e nevojshme logjistike te pershtatshme per ushtrimin e veprimtarise se auditimit kur auditimi kryhet jashte ambjenteve te Bashkise.
- Ti paraqese kerkese drejtuesit te njesise se auditimit per heqjen dore nga nje veprimtari auditimi ,kur vleresojne se per shkaqe te argumentuara cenohen besueshmeria dhe cilesia e auditimit ose ne rastet kur veprimtaria e audituese eshte ne kushtet e konfliktit te interesit.
- Te ndjekin ne menyre periodike,trajnimin e vijueshem profesional sipas kerkesave te ligjit per Auditimin e Brendshem.

Drejtuesi i njesise se auditit dhe audituesit nuk jane te autorizuar:

a) Te kryejne detyre operacionale brenda Institucionit te Bashkise Prrenjas.
b) Te jene te zgjedhur ne strukturat drejtuese te partive politike.
c) Te ushtrojne cdo veprimtari ose pune tjeter me pagese,ose te kene perfitime te tjera te natyrave dhe formave qe i bejne te jene ne konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.
d) Te drejtoje veprimtarite e punonjesve qe nuk jane te punesuar nga Njesia e Auditimit te Brendshem,pervecse kur keta punonjes jane caktuar ne grupet e auditimit sipas nevojes ose ne nje menyre tjeter per te ndihmuar audituesit e brendshem.
e) Te shmange problemet qe kercenojne pavaresine dhe pengojne audituesit te kryeje nje angazhim auditimi,duke njoftuar paraprakisht me shkrim,drejtorine e auditimit te brendshem per cdo konflikt te mundshem interesi.

VI. PERGJEGJSHMERIA ,LINJAT E RAPORTIMIT TE DREJTUESIT TE SEKTORIT TE AB,MENYRAT DHE FORMAT E RAPORTIMIT.

Pergjegjesi i Njesise se Auditit te Brendshem ne permbushjen e detyrave te veta eshte pergjegjes perpara menaxhimit qe:

1. Te jape vleresime vjetore per titullarin e Njesise Publke ,mbi pershtatshmerine dhe efektivitetin e kontrollit te brendshem dhe menaxhimit te risqeve te rendesishme dhe per objektin e dokumentuar te punes audituese.
2. Te raportoje rregullisht per dobesite thelbesore te identifikuara nga auditimi,se bashku me rekomandime per permiresimin e mjedisit te kontrollit te brendshem.
3. Te informoje periodikisht menaxhimin e larte ,mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor te auditimit dhe mjaftueshmerine e burimeve te Sektorit te Auditimit te Brendshem.
4. Te kordinoje dhe mbikqyre funksionet e tjera te kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e riskut,perputhshmerine,sigurine,ligjshmerine,etiken,mjedisin dhe auditimin e jashtem.)

Plani i auditimit te brendshem

Pergjegjesi i njesise se AB gjate hartimit te planit duhet te kete parasysh:

1. Pas konsultimit me menaxhimin e larte ,cdo vit ,do ti paraqese Titullarit te Bashkise Publike dhe Komitetit te Auditimit (nese ka) nje plan auditimi te brendshem per shqyrtim dhe miratim.Ky plan duhet te jape nje informacion mbi punen qe do te kryeje njesia e auditimit gjate nje viti,ne te cilin perfshin kerkesat per buxhetin dhe burimet qe do te perdoren gjate vitit te ardhshem kalendarik.
2. Te komunikoje ndikimin e kufizimeve te burimeve si dhe ndryshimet e rendesishme te planit te kontrollit tek manaxhimi i larte .
3. Te zhvilloje ne baze te prioritetit te universit te auditimit duke perdorur metodologji qe bazohet ne vleresimin e riskut duke perfshire dhe kontributin e menaxhimit te larte.
4. Te shqyrtoje dhe te rregulloje planin,sipas nevojes ne pergjigje te ndryshimeve te aktivitetit te njesise,rreziqeve,operacioneve,programeve,sistemeve dhe kontrolleve.Cdo devijim i rendesishem nga plani i aprovuar i auditimit te brendshem do ti komunikohet Titullarit per miratim.

Raportimi dhe monitorimi

Raportimi .

1. Ne perfundim te cdo viti kalendarik pergatitet nje Raport Vjetor i cili permban te dhenat e meposhtme por nuk kufizohet vetem ne to:

a) Angazhimet e auditimit te kryer gjate periudhes se raportuar.
b) Shmangiet nga plani,arsyet dhe argumentet perkatese.
c) Vleresimin e sistemeve te kontrollit brenda sistemit si dhe rekomandimet per permiresim.
d) Veprimet e ndermarra nga menaxhimi per zbatimin e rekomandimeve si dhe cdo rekomandim te pazbatuar.

2. Raporti vjetor dhe pasqyrat te cilat evidentojne te dhenat analitike per cdo subjekt te audituar per periudhen raportuese duhet te pergatiten brenda afateve te percaktuara ne manualin e AB dhe nje kopje e tyre duhet te dergohet per informacion.
    a) Struktures pergjegjese per harmonizimin e auditimit te brendshem ne Ministrine e Financave dhe Ekonomise.
3. Raporti vjetor dhe pasqyrat perkatese pergatiten nga pergjegjesi i sektorit te AB ose nje auditues i caktuar prej tij.
4. Audituesit duhet te raportojne menjehere te pergjegjesi i sektorit te auditit kur zbulohen parregullsi apo veprime qe ne vleresimin e tyre perbejne veper penale.
5. Pergjegjesi i Njesise se AB raporton menjehere ne forme te shkruar te Titullari i Bashkise i cili sipas gjykimit njofton inspektimin financiar publik kur zbulon parregullsi apo veprime qe ne vleresimin e bere nga grupet e punes dhe vete drejtuesi i njesise perbejne veper penale.

Monitorimi

1. Pergjegjesi i Njesise se AB duhet te hartoje procesin e ndjekjes se rekomandimeve per te monitoruar dhe per tu siguruar qe veprimet e menaxhimit jane zbatuar me efektivitet ose qe drejtuesit e nivelit te larte te menaxhimit e kane pranuar riskun qe vjen nga mos marrja e veprimeve korrigjuese duke pasur parasysh:
   a) Te sigurohet qe subjekti ka zbatuar rekomandimet e bera me pare pike e cila duhet te parashikohet ne cdo angazhim auditimi.
   b) Te sigurohet qe plani i veprimit te miratohet nga menaxhimi i larte i subjektit te audituar material i cili duhet te depozitohet ne dosjen e auditimit.
   c) Te informoj me shkrim Titullarin kur menaxheri i larte i subjektit te audituar nuk ka permbushur pergjegjesit e tij lidhur me miratimin e planit te veprimit brenda afateve te percaktuara ne Manualin e AB.
   d) Mund ti dergoje menaxherit te larte te subjektit te audituar shkresa rikujtese kur paraqiten shqetesime per rekomandimet e pazbatuara ose rekomandime qe jane vleresuar me nivel risku te larte dhe qe ndikojne drejteperdrejte ne arritjen e objektivave.
   e) Ne fund te vitit mund tu kerkohet te raportojne me shkrim,drejtuesve te subjekteve te audituara lidhur me zbatimin e rekomandimeve te lena.
2. Grupi i auditimit duhet te vleresoje progresin e bere nga subjektet e audituara ne rastet kur per zbatimin e rekomandimeve kerkohet me shume kohe dhe jo vetem te prese nese cdo gje eshte bere sipas afatit te rene dakort.

VII. SIGURIMI I CILESISE DHE PROGRAMI I PERMIRESIMIT

Pergjegjesi i Njesise se AB duhet te zhvilloje dhe te mirembaje programin e siguridhenies dhe permiresimit te cilesise ,i cili mbulon te gjitha aspektet e veprimtarise se auditimit te brendshem.Programi i sigurimit te cilesise eshte projektuar per te mundesuar vleresimin e perputhshmerise se veprimtarise se auditimit te brendshem me qellimin e krijimit te sherbimit te AB,si dhe per te vleresuar nese audituesit e brendshem zbatojne Kodin e Etikes dhe Standartet. Programi per vleresimin e cilesise perbehet nga vleresimet e brendshme dhe te jashtme dhe perfshin:

1. **Vleresimin e brendshem te cilesise** qe kryhet nga vete njesia e auditimit te brendshem bazuar ne politikat dhe praktikat e saj,i cili duhet te perbehet nga komponentet e meposhtem:
   a) Monitorimi i vazhdueshem i performances se veprimtarise se auditimit te brendshem nga vete audituesi,i cili eshte pjese integrale e Programit te Permiresimit dhe Vleresimit te Cilesise dhe qe nuk nenkupton rishikimin dhe trajnimin e audituesve.
   b) Vete vleresim periodik nga njesia e AB i cili eshte nje tjeter komponent integral i Programit te Cilesise dhe kryhet per vleresuar perputhshmerine me parimet baze te Struktures Nderkombetare per Praktikat Profesionale (IPPF) si Perkufizim i auditit te brendshem,Kodi i Etikes,standartet nderkombetare si dhe me kerkesat specifike te Manualit te AB.
   c) Studimi i nje subjekti te audituar nepermjet reagimeve pas perfundimit te nje angazhimi auditimi,por duke pasur parasysh se ky reagim nuk mund te jete plotesisht objektiv.

2. **Vleresimin e jashtem te cilesise** qe kryhet nga struktura pergjegjese per harmonizimin e auditit te brendshem ne sektorin publik per zbatimin e metotologjise dhe performances se njesise se AB.
   a) Kjo strukture eshte organi pergjegjes per monitorimin dhe vleresimin ne menyre periodike te veprimtarise te sektorit te AB,ne perputhje me standartet nderkombetare te miratuara.
   b) Struktura pergjegjese per harmonizimin e AB duhet te vleresoje njesine e auditit te brendshem te pakten nje here ne 5 vjet.

VIII. STANDARTET E PRAKTIKAVE TE AUDITIMIT

Njesia e AB Bashkia Prrenjas pervec legjislacionit te fushes do te permbushe dhe zbatoje Standartet Nderkombetare mbi "Praktikat Profesionale te Auditimit te Brendshem" te emertuara nga Instituti i Audituesve te Brendshem (IIA) si dhe nga kerkesat e Kodit te Etikes se Auditimit te Brendshem.

NJESIA E AUDITIT TE BRENDSHEM

BASHKIA PRRENJAS